REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:073703
Datë: 07.06.2022
Numri i dokumentit: 03103559

C.nr.495/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirjeta Shala, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëseve G. J., M. S., Z. P. dhe M. B., që te gjithë nga Gjakova, të cilat sipas autorizimit i përfaqëson i Arben Biblekaj, avokat në Prishtinë, rruga "F. A." Hy – .., kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, të cilinë e përfaqëson Dardan Bakija, me autorizim, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit në punë, vlera e kontestit 5,317.20 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik të mbajtur me, në prezencën e të autorizuarit të paditëseve dhe përfaqësuesit të paditurës, me datë mori 18 maj 2022, mori këtë:

A K T GJ Y K I M

I. APROVOHET e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditësit G. J., nga Gjakova, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditësit G. J. nga Gjakova, që në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, për periudhën kohore nga data 14.09.2020 e deri me datën 11.03.2022, për 303 ditë pune, të i'a paguajë shumën prej 606,00 euro, si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, për periudhën kohore 16.04.2018 e deri me datën 11.03.2022, për 633 ditë pune të i'a paguajë shumën prej 443,10 euro, përkatësisht në shumë të përgjithshme prej 1,049.10 euro, me kamatën ligjore prej 8% duke filluar nga ata 15.04.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranim të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

II. APROVOHET e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditësit M. S., nga Gjakova, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditësit M. S., nga Gjakova, që në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, për periudhën kohore nga data 14.09.2020 e deri me datën 31.12.2020, për 64 ditë pune, të i'a paguajë shumën prej 128,00 euro, si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, për periudhën kohore 16.04.2018 e deri me datën 31.12.2020, për 385 ditë të pranisë në pune të i'a paguajë shumën prej 269,50 euro, përkatësisht në shumë të përgjithshme prej 397,50 euro, me kamatën ligjore prej 8% duke filluar nga ata 15.04.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha

2021:073704

këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranim të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

III. APROVOHET e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditësit Z. P., nga Gjakova, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditësit Z. P., nga Gjakova, që në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, për periudhën kohore nga data 14.09.2020 e deri me datën 11.03.2022, për 303 ditë pune, të i'a paguajë shumën prej 606,00 euro, si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, për periudhën kohore 16.04.2018 e deri me datën 11.03.2022, për 633 ditë të pune të i'a paguajë shumën prej 1,329.30 euro, përkatësisht në shumë të përgjithshme prej 1,935.30 euro, me kamatën ligjore prej 8% duke filluar nga ata 15.04.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranim të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

IV. APROVOHET e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditësit M. B., nga Gjakova, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditësit M. B., nga Gjakova, që në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, për periudhën kohore nga data 14.09.2020 e deri me datën 11.03.2022, për 303 ditë pune, të i'a paguajë shumën prej 606,00 euro, si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, për periudhën kohore 16.04.2018 e deri me datën 11.03.2022, për 633 ditë të pune të i'a paguajë shumën prej 1,329.30 euro, përkatësisht në shumë të përgjithshme prej 1,935.30 euro, me kamatën ligjore prej 8% duke filluar nga ata 15.04.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranim të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

V. Padia e paditësit Sh. A. e ushtruar kundër të padituri Komuna e Gjakovës -Drejtoria Komunale e Arsimit, në këtë çështje juridike civile, konstatohet e tërhequr.

VI. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurë, të i'au paguaj shumën prej 1,346.00 euro, në afatin prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësit në këtë gjykatë me datë 15.04.2021 përmes të autorizuarit të lartpërmendur të tyre, kanë parashtruar padi, kundër të padituris Komuna e Gjakovës, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, kjo pasi që të njëjtët janë punëtor të arsimit në SHFMU "B. S." në fshatin B., komuna e Gjakovës. Ka shtuar se kërkesa e tyre që ka të bëjë me kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë punës gjen zbatim në Kontratën e Arsimit të Kosovës, konkretisht kapitulli IV, neni 35, parg. 7, ndërsa parg. 5, ku paditësve për çdo ditë të pranisë në punë në emër të shpenzimeve të ushqimit iu takon vlera re 2 euro në ditë, ndërsa për faktin se paditësit kanë udhëtuar nga vendbanimet e tyre për në vendpunimin e tyre, të njëjtëve iu takon 70% e çmimit të biletës së trafikut urban. E paditura deri në momentin e ushtrimit të padisë lëndore nuk e ka përmbushur obligimin që rrjedhë nga marrëveshje dhe kontrata e

lartcekur, përkundër kërkesës së paditëseve të cilën e kanë parashtruar në procedurë administrative, për çka të njëjtat kanë qenë të detyruara të parashtrojnë padi në këtë gjykatë dhe të kërkojnë realizimin e të drejtës së tyre subjektive. I autorizuari i paditësve me parashtresën e datës 22.03.2022, 27.04.2022 dhe parashtresën e datës 18.05.2022(të dorëzuar drejtpërdrejte në seancën e shqyrtimit kryesore të çështjes ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në aspektin objektiv për dhe atë: për paditësin G. J., Z. P. dhe M. B., duke kërkuar ne emër te kompensimit te shpenzimeve te ushqimit për periudhën kohore nga data 14.09.2020 e deri me datën 11.03.2022 (secili prej tyre nga 303 ditë punë), ndërsa për shpenzimet e ushqimit për periudhën kohore nga data 01.04.2018 e deri e datën 11.03.2022 (secili nga ta për 633 ditë punë të realizuar) ndërsa për paditësin M. S., për shpenzimet e ushqimit për periudhën kohore nga data 14.09.2020 deri me datën 31.12.2020 (64 ditë pune), dhe për shpenzimet e udhëtimit nga data 16.04.2018 e deri me datën 31.12.2020 për 385 ditë punë.

I autorizuar i paditësve në padinë e precizuar, në fjalën e dhënë në seancën e shqyrtimit kryesorë dhe në fjalën e tij përfundimtarë, ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë padisë së precizuar, duke i propozuar gjykatës që padia dhe kërkesëpadia e precizuar e paditësve të aprovohet si e bazuar, ashtu që të detyrohet e paditura që paditësve në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit te i'au paguaj si në vijim: G. J., shumën e përgjithshme prej 1,049.10 euro, M. S. shumën e përgjithshme prej 397,5 euro, Z. P. shumën e përgjithshme prej 1,935.30 euro, dhe M. B., shumën prej 397.50 euro, Z. P. dhe M.B., shumën e përgjithshme prej 1,935.30 euro, të gjitha këto me kamatën ligjore prej 8% duke filluar nga 15.04.2021(datë e parashtrimit të padis) e deri në pagesën definitive, ne afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

Shpenzimet procedurale i kërkojmë dhe atë: taksën gjyqësore për padi në vlerë prej 20,00 €, për përpilimin e padisë prej 312,00 €, për përfaqësim në tri seancë gjyqësore nga 405,00€ për secilën seancë, për përpilimin e parashtresës për precizimin e kërkesëpadisë së datës 22.03.2022 shumën prej 312,00 apo në shumën e përgjithshme 1,859.00 euro.

Përfaqësuesi i të padituërës deklaron se kontrata e kolektive e arsimit në Kosovë e nënshkruar në mes MASHT dhe SBASHK-ut me dt. 22.01.2021, ka shfuqizuar me nenin 47 të saj, ka shfuqizuar Kontratën kolektive të vitit 2017, ashtu edhe sipas nenit 35 par. 5 që ka të bëjë me shpenzimet e rrugës dhe nenit 35 par. 7 që ka të bëjë me shujta, por duke pas parasysh se dispozitat kalimtare në nenin 45 par. 1, akoma nuk është bërë një planifikim i buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e këtyre dispozitave deri sa të krijohen mundësit financiare në buxhetin e R. Kosovës, por jo më vonë se viti 2023. Andaj edhe sipas Qarkores buxhetore 2022/01 i dt. 14.05.2021, të lëshuar nga z. Hekuran Murati Ministër Financave në grandin specifik të arsimit para universitar nuk është e paraparë pagesa e udhëtimit të mësimdhënëseve dhe kompensimit të ushqimit në punë, si dhe lidhur me këtë kërkesë thirremi në parashkrim të paraparë sipas nenit 87 të Ligjit të Punës, përkatësisht duke pas parasysh që padia është paraqit me dt. 15.04.2021 konsideroi që kërkesat e paditësve janë të parashkruara brenda afatit prej 3 viteve para paraqitjes së padisë, respektivisht 15.04.2018.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Kontratë pune për paditësin G. J., e lëshuar nga Komuna e Gjakovë – Drejtoria e Arsimit, në versionin e fotokopjuar me numër të kontratës 523/01,vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "B. S." nga fshati B.-Gjakovë i dt. 11.03.2022, vërtetimi i SHFMU "B. S." nga fshati B.-Gjakovë me numër të protokollit 781 dt.21.04.2022, certifikata e vendbanimin për paditësit G. J., e lëshuar nga Zyra e gjendjes Civile në Gjakovë me dt.09.03.2022, vërtetimi i lëshuar nga shoqata e transportit për paditësin G. J., kontratë pune për paditësin M.S., e lëshuar nga Komuna e Gjakovë – Drejtoria e Arsimit, në versionin e fotokopjuar me numër të kontratës 586, vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "B. S." nga fshati B.-Gjakovë i dt. 11.03.2022, vërtetimi i SHFMU "B. S." nga fshati B.-Gjakovë me numër të protokollit 782 dt.21.04.2022, certifikata e vendbanimin për paditësit M. S., e lëshuar nga Zyra e gjendjes Civile në Gjakovë me dt.09.03.2022, vërtetimi i lëshuar nga shoqata e transportit për paditësin M. S., kontratë pune për paditësin Z. P., e lëshuar nga Komuna e Gjakovë – Drejtoria e Arsimit, në versionin e fotokopjuar me numër të kontratës 533/01, vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "B. S." nga fshati B.-Gjakovë i dt. 11.03.2022, vërtetimi i SHFMU "B. S." nga fshati B.-Gjakovë me numër të protokollit 784 dt.21.04.2022, certifikata e vendbanimin për paditësit Z. P., e lëshuar nga Zyra e gjendjes Civile në Gjakovë me dt.08.03.2022, vërtetimi i lëshuar nga shoqata e transportit për paditësin Z. P., kontratë pune për paditësin M.B., e lëshuar nga Komuna e Gjakovë – Drejtoria e Arsimit, në versionin e fotokopjuar me numër të kontratës 526/01, vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "B. S." nga fshati B.-Gjakovë i dt. 11.03.2022, për paditësin M. B., vërtetimi i SHFMU "B. S." nga fshati B.-Gjakovë me numër të protokollit 783 dt.21.04.2022, certifikata e vendbanimin për paditësit M. B., e lëshuar nga Zyra e gjendjes Civile në Gjakovë me dt.09.03.2022, vërtetimi i lëshuar nga shoqata e transportit për paditësin M. B. .

Gjykata pas analizimit të fakteve juridike relevante të kësaj çështjeje, vlerësimit veç e veç të provave dhe lidhshmërinë e tyre reciproke, e në kuptim të nenit 8 të LPK-së, vërtetojë se kërkesëpadia e precizuar e paditëseve, është në tërësi e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga provat e administruara, u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

Nga Kontratë pune për paditësin G. J., me numër të kontratës 523/01, është vërtetuar fakti se ei njëjta është në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht në Institucionin Arsimor : shkolla "B. S.", në fshatin B., komuna e Gjakovës, pozita: mësimdhënës dhe kohëzgjatja e kontratës së punës është 01.09.2015 – e përhershme. Vërtetimi i lëshuar nga po ky institucion i datë 11.03.2022, provon rrethanën se këtu paditësi në institucionin e lartpërmendur nga data 14.09.2020 deri me datë 11.03.2022, ka të mbajtura 303 ditë pune(i cili i referohet shpenzimeve të ushqimit), ndërsa fakti se paditësi për periudhën kohore nga data 16.04.2018 e deri me datën 11.03.2022, ka vijuar 633 ditë të pranisë në punë, që i referohet shpenzimeve të udhëtimit, e vërteton vërtetimi me Nr.prot.781 i datës 21.04.2022. Certifikata e vendbanimit me nr. B 1037148 e lëshuar nga Zyra e Qendrës Civile në Gjakovë, për paditësin G. J., provon faktin se i njëjti jeton në fshatin N., komuna e Gjakovës, si dhe Vërtetimi i lëshuar nga Shoqata e Transporti të Udhëtarëve në Gjakovë, provon faktin se çmimi i biletës nga fshati D.-N., në një drejtim kushton 0.50 cent.

Nga Kontratë pune për paditësin M. S., me numër të kontratës ..., është vërtetuar fakti se ei njëjta është në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht në Institucionin Arsimor : shkolla "B. S." në fshatin B., komuna e Gjakovës, pozita: mësimdhënës dhe kohëzgjatja e kontratës së punës është 01.09.2015 – e përhershme. Vërtetimi i lëshuar nga po ky institucion i datë 11.03.2022, provon rrethanën se këtu paditësi në institucionin e lartpërmendur nga data 14.09.2020 deri me datë 31.12.2020 ka të mbajtura 64 ditë pune(i cili i referohet shpenzimeve të ushqimit), ndërsa fakti se paditësi për periudhën kohore nga data 16.04.2018 e deri me datën 31.12.2020 ka vijuar 385 ditë të pranisë në punë, që i referohet shpenzimeve të udhëtimit, e vërteton vërtetimi me Nr.prot.782 i datës 21.04.2022. Certifikata e vendbanimit me nr. B 10371483 e lëshuar nga Zyra e Qendrës Civile në Gjakovë, për paditësin M. S., provon faktin se i njëjti jeton në fshatin N., komuna e Gjakovës, si dhe Vërtetimi i lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve në Gjakovë, provon faktin se çmimi i biletës nga fshati D.-N., në një drejtim kushton 0.50 cent.

Nga Kontratë pune për paditësin Z. P., me numër të kontratës .../.., është vërtetuar fakti se i njëjti është në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht në Institucionin Arsimor : shkolla "B. S.", në fshatin B., komuna e Gjakovës, pozita: mësimdhënëse dhe kohëzgjatja e kontratës së punës është 01.09.2015 – e përhershme. Vërtetimi i lëshuar nga po ky institucion i datë 11.03.2022, provon rrethanën se këtu paditësi në institucionin e lartpërmendur nga data 14.09.2020 deri me datë 11.03.2022, ka të mbajtura 303 ditë pune(i cili i referohet shpenzimeve të ushqimit), ndërsa fakti se paditësi për periudhën kohore nga data 16.04.2018 e deri me datën 11.03.2022, ka vijuar 633 ditë të pranisë në punë, që i referohet shpenzimeve të udhëtimit, e vërteton vërtetimi me Nr.prot.784 i datës 21.04.2022. Certifikata e vendbanimit me nr. B 1037148 e lëshuar nga Zyra e Qendrës Civile në Gjakovë, për paditësin Z. P., provon faktin se i njëjti jeton në fshatin N., komuna e Gjakovës, si dhe Vërtetimi i lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve në Gjakovë, provon faktin se çmimi i biletës nga fshati D.-N., në një drejtim kushton 0.50 cent.

Nga Kontratë pune për paditësin M. B., me numër të kontratës .../.., është vërtetuar fakti se i njëjti është në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht në Institucionin Arsimor : shkolla "B. S.", në fshatin B., komuna e Gjakovës, pozita: mësimdhënës dhe kohëzgjatja e kontratës së punës është 01.09.2015 – e përhershme. Vërtetimi i lëshuar nga po ky institucion i datë 11.03.2022, provon rrethanën se këtu paditësi në institucionin e lartpërmendur nga data 14.09.2020 deri me datë 11.03.2022, ka të mbajtura 303 ditë pune(i cili i referohet shpenzimeve të ushqimit), ndërsa fakti se paditësi për periudhën kohore nga data 16.04.2018 e deri me datën 11.03.2022, ka vijuar 633 ditë të pranisë në punë, që i referohet shpenzimeve të udhëtimit, e vërteton vërtetimi me Nr.prot.784 i datës 21.04.2022. Certifikata e vendbanimit me nr. B 10371486 e lëshuar nga Zyra e Qendrës Civile në Gjakovë, për, paditësin M.B., provon faktin se i njëjti jeton në Gjakovë, Rr." F. K.", Nr. ., si dhe vërtetimi i lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve në Gjakovë, provon faktin se çmimi i biletës Gjakovë-B., në një drejtim kushton 1.50 cent.

Gjykata duke u bazuar në të gjitha provat e sipër administruara, dhe në dispoziatat e nënti 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë datë 18.04.2017 dhe Kontratën e datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: "*Të punësuarve iu njihet e drejta*

2021:073704

për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim pagese (2 euro), të te punësuarve për ushqim për t'a bërë kompensimin", erdhi në përfundim se kërkesëpadia e precizuar e paditëseve për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për paditësit G. J., Z. P. dhe M. B., për periudhën kohore nga data 14.09.2020 – 11.03.2022, për 303 ditë të pranisë në punë për secili nga ta, ndërsa për paditësin M. S., për periudhën kohore nga data 14.09.2020 – 31.12.2020 për 64 ditë të pranisë në punë, është në tërësi e themeltë, dhe si e tillë u aprovua, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit bëri përllogaritjen në atë mënyrë që, e ditët e kaluara në punë të paditësve i ka shumëzuar me 2 euro, ashtu që e paditura e cila në rastin konkret e posedon legjitimitetin e plotë pasiv është e detyruar që të iu kompensojë këtë lartësi këtu paditëseve siç më përafërsisht është vendosur në pikën I, II, III dhe IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në nenin 35 parg. 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit e datës 18.04.2017 dhe të asaj të datës 22.01.2021, në mënyrë të njëjtë është paraparë se: *"Mësimdhënësit që udhëtojnë në vendbanimet e Komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban"*. Nga provat e administruara, gjykata konstatoi se paditësi G. J. jeton në fshatin N., vërtetuar sipas Certifikata e vendbanimit me nr. B 1037148 e lëshuar nga Zyra e Qendrës Civile në Gjakovë, po ashtu certifikata e vendbanimit për paditësin M. S., e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakove, më Nr. B 10371483 provojë rrethanën se i njëjti jeton në fshatin N.. Ndërsa paditësi Z. P. sipas certifikatës së vendbanimit me Nr. B 1037148 e lëshuar nga Zyra e Qendrës Civile në Gjakovë vendbanimin e ka në Gjakovë si dhe paditësi M. B., po ashtu jeton në Gjakovë, fakt ky i provuar nga Certifikata e vendbanimit me nr. B 10371486 e lëshuar nga Zyra e Qendrës Civile në Gjakovë. Lartësinë e kërkesëpadisë lidhur me këtë kriter të kompensimit, gjykata e vërtetojë në bazë të vërtetimit të lëshuar nga Shoqata e Transportit në Gjakovë, ku lartësia e çmimit të biletës për relacionin më të afërt nga vendbanimi i tyre për në vendpunimin e tyre është fshati D. (pasi që nuk ka linjë direkt për në fshatin B.) për paditësin G. J. dhe M. S., është 1, 00 euro në ditë për të dy drejtimet, ndërsa për paditësit Z. P. dhe M. B., nga Gjakova për në fshatin B., është 3,00 euro në ditë për të dy drejtimet. Andaj, duke pasur parasysh që e paditura, paditësve nuk i'au ka paguar shpenzimet e udhëtimit e parapara me dispozita ligjor të lartëcekura, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e themeltë, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhetimit bëri përllogaritjen në atë mënyrë që, ditët e kaluara në punë të paditësve i ka shumëzuar me 70% të çmimit të biletës së trafikut urban në relacionet ku e të njëjtit kanë udhëtuar duke i'au njohur shumat si në pikën I , II, II dhe IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, me rastin e vendosjes murr parasysh edhe nenin 90 paragrafi 5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, me të cilin parashihet se: "*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive".* Sipas neneve të lartë cituara të Kontratë Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë detyrimi i punëdhënësit në rastin konkret i të paditurës për kompensimin e

2021:073704

shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit e nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e cila prodhon efekt juridik ndaj punëdhënëses të cilët kanë të punësuar punëtorët që të drejtat e tyre burojnë nga ajo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditëses dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ato kontrata.

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në "Gazetën Zyrtare" të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: "*Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij*". Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: "*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij",* prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditorit, përkatësisht këtu paditëseve, të ia paguajë vlerën e precizuar të kërkesëpadisë si dhe shpenzimet tjera akcesore, siç më detajisht është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8 %, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur prej e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Gjykata, pretendimet e të padituërës se nuk ka planifikim buxhetor për këto kompensime, i gjen si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme. Paditësja në rrugë gjyqësore ka filluar të realizoj një të drejtë ligjore që i garanton Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë me nr. 01B-2056 e datës 18.04.2017 dhe ajo e viti 2021 kurse mungesa e buxhetit të padituërës, nuk mund të ketë për efekt vendosje ndryshe si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Sa i përket pretendimit të padituërës për parashkrimin e kërkesës për periudhën kohore para datës 15.04.2018, gjykata nuk u lëshua në vlerësimin e tij, pasi që i autorizuari i paditësve ka bërë tërheqjen e kërkesëpadisë së paditësve lidhur me këtë periudhë kohore.

Gjykata me aktvendimin C.nr.495/2021 të datës 19.04.2022 e ka konstatuar të tërhequr padinë për paditësin Sh. A., pasi që i autorizuari i tij drejtpërdrejtë ne seancë e ka njoftuar gjykatën se benë tërheqjen e padisë lidhur me këtë paditës. Andaj gjykata ka vepruar duke iu referuar nenit 261 par.2 të LPK-së, pasi që edhe i përfaqësuesi i të padituërës nuk e ka kundërshtuar.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç 'rast paditësve i'u pranua shume e shpenzimeve në vlerë prej 1,346.00 euro, e cila i'u referohet: shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësorë në vlerë prej 20,00€(e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 312,00€, euro si dhe përfaqësimin e të autorizuarit të paditësve në tri seancë, në vlerë prej 1,014 euro (338x3 të parapara sipas tarifës së OAK-së). Ndërsa nuk i'u pranua shuma prej 513,00 euro, kjo për faktin se përfaqësimi për një seancë në vlerën e kërkuar nga i autorizuari i paditësve prej 405.00€, parashihet kur kemi te bëjmë me të padituri n/paditësin e pestë e paraparë sipas Tarifës Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 7 paragrafi 2), e që në rastin konkret kemi të bëjmë me katër paditës, pasi që i autorizuari i paditësit është tërhequr ndaj njërit paditësit

Sh. A. si dhe nuk iu pranua shuma prej 312, 00 euro, e cila shumë i referohet përpilimit të parashtresës për precizim të kërkesëpadisë (datë 22.03.2022) meqë përmbajtjen e të njëjtës parashtresë, i autorizuari në fjalë ka mundur që të e paraqesë në shqyrtim.

Prandaj, gjykata, bazuar ne arsyet e cekura me larte, bazuar ne nenin 143 të LPK-së, vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.495/2021, me 18 maj 2022

Gj y q t a r e,
Mirjeta Shala

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.